



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS  
THE UNION OF INDEPENDENT TRADE UNIONS OF KOSOVA

Adresa:Rr."Nëna Terezë" 35, 10 000 PRISHTINË,  
Tel/fax:++381(0)38 229 838, e-mail:bspk@etuc.org



### Tryezë e rrumbullakët – 1 Maji festë apo protestë?

**Prishtinë 29 prill 2011-** Me rastin e 1 Majit, Ditës Ndërkombëtare të Punës, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) me përkrahje nga Friedrich-Ebert-Stiftung (FES) ka organizuar Tryezë të rrumbullakët në temën: 1 Maji - festë apo protestë?, më 29 prill 2011, në Hotel Prishtina. Në këtë Tryezë, krahas të tjerëve, ishin të pranishëm: Ministri i Punës dhe i Mirëqenies Sociale z.Nenad Rashiq, Zineta Daci (OEK), Behxhet Shla (KMDLNJ), Agim Shahini (AKB), Valon Murati, Qendra për të Drejtat e Njeriut dhe Kreshnik Cukaj- Kuvendi i të Rinjve të Kosovës. 1 Maji -Dita Ndërkombëtare e Punës shënohet si një përvjetor zyrtarë i cili i referohet kujtimit të protestave të punëtorëve që synon të drejta më të madha dhe liri sindikale. Në përvjetorët e kësaj date shpesh herë shtrohet pyetja se më 1 maji a duhet të festohet apo të protestohet? BSPK-ja, tre vitet e fundit e ka shënuar këtë ditë me

organizim të protestave. Mirëpo, duke u bazuar në të arriturat në periudhën e fundit dhe duke u nisur nga fakti i mosgatishmërisë për dalje masovike në protestat e kaluara, këtë vit BSPK-ja ka vendosur që këtë ditë ta përkujtoj përmes një Tryeze të rrumbullakët. Në këtë tryezë u diskutuan dhe u elaboruan problemet e shumta me të cilat ballafaqohen punëtorët kosovarë. Një nga temat kryesore të kësaj Tryeze ishin: implementimi i Ligjit të Punës si dhe nxjerrja e Ligjit mbi Organizimin Sindikal.

Kryetari i BSPK-së Haxhi Arifi, në prani të mysafirëve dhe të ekspertëve të shumtë, shtoi si nevojë urgjente dhe të domosdoshme implementimin e Ligjit të Punës dhe respektimin e tij. Në vazhdim Arifi ka thënë se një ndër problemet që po përballet vendi ynë është papunësia dhe varfëria e madhe, por edhe gjendja shumë e rëndë e punëtorëve të punësuar në sektorin privat. Ai shtoi se punëtorët e shumë kompanive private punojnë pa kontrata pune, gjë e cila sanksionohet me Ligjin e Punës. Pos kësaj, punëtorët në fjalë punojnë edhe me orar të stërzgjatur, për të cilat nuk marrin kompensim adekuat. “Po të implementohej Ligji i Punës në tërësi, atëherë do të liroheshin edhe shumë vende të reja pune”, theksoi kryetari Arifi.

BSPK-ja, për fillim është e interesuar për implementimin e Ligjit në tërësi, me ç’rast shumë probleme do të tejkaloheshin apo pakënaqësitë e punëtorëve do të zvogëloheshin.

Në fund të Tryezës u tha që domosdoshmërisht duhet të respektohet Ligji i Punës dhe legjislacioni tjetër, sepse në të kundërtën do të duhej të aplikoheshin gjobat tejet të larta, diku 30 mijë euro. Nga Tryeza doli edhe nevoja që të punohet në vetëdijesimin më të madh qoftë të punëtorëve për të drejtat e tyre dhe lirinë e organizimit sindikal të tyre, por edhe të punëdhënësve që të respektojnë këto të drejta.

**Zyra për Informim, BSPK  
Fatma Rastelica**